



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT
PËR VITIN 2027-2029

Dëgjimi i parë buxhetor PROCESVERBAL

Data: 12.06.2026

Ora: 11:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Junik

Të pranishëm:

- Z. Besart Tofaj – Nënkyetar i Komunës
- Znj. Ardita Hoxha – Drejtore për Buxhet dhe Financa
- Z. Arten Hamza – Zyrtar kryesor financiar
- Përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë të komunës

Pika e rendit të ditës:

- Prezantimi i Kornizës Buxhetore Komunale 2027–2029 sipas Qarkores së Parë Buxhetore.

Ecuria e takimit

Takimin e hapi Z. Arten Hamza, zyrtar kryesor financiar dhe njëherit kryesues i GP i formuar me vendim të kryetarit të komunës, i cili përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen. Ai njoftoi të pranishmit lidhur me përbërjen e grupit punues, datat e planifikuara për mbajtjen e dëgjimeve publike dhe prezantoi Qarkoren e Parë Buxhetore.

Më pas, Z. Hamza bëri prezantimin e Kornizës Buxhetore Komunale për periudhën 2027–2029, duke u fokusuar në burimet e financimit të komunës, ndryshimet krahasuar me vitin paraprak dhe planifikimin e shpenzimeve për vitet në vijim. Sa i përket procesit buxhetor sikurse edhe vitet e kaluara bazuar në LMFP secila organizatë buxhetore e nivelit lokal dhe qëndror është e obliguar që të filloj me procesin e hartimit të dokumenteve strategjike ku një ndër to është edhe Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029. Në kuadër të këtij procesi kryetari ka formuar grupin punues i cili merret me procesin e planifikimit buxhetor dhe me organizimin e dëgjimeve buxhetore ne bazë të të cilave synohet mbledhja e sa më shumë ideve për projekte të nevojshme

për strategjinë zhvillimore komunale pastaj të klasifikohen sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore për implementimin e tyre.

Pas formimit të grupit kemi filluar procesin e planifikimit bazuar në qarkoren e parë buxhetore 2027/1, në të cilën janë të përcaktuara limitet e financimit të organizatës buxhetore. Buxheti i Komunës së Junikut përbëhet nga këto burime të financimit: granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit, granti specifik i shëndetësisë, të hyrat vetanake dhe donacionet.

Pas lëshimit të qarkores së parë 2027/1 fillimisht kërkohet aprovimi i KAB-it në Kuvendin Komunal deri me 30 qershor 2026, ku pastaj do të vazhdohet me procedurat tjera ku do të pranojmë edhe qarkoren e dytë buxhetore e cila do të përcaktoj limitet e kategorive ekonomike dhe do të procedohet me hartimin e buxhetit komunal për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028 dhe 2029 që ti prezantohen Kuvendit Komunal për aprovim deri në fund të muajit shtator dhe më pas të dorëzohet në Ministrinë e Financave.

Në si grup punues kemi hartuar kalendarin dhe planin e dëgjimeve publike ku do të organizojmë gjithsej 4 dëgjime, i pari ky që po e mbajmë sot për hartimin e KAB-it, i dyti në korrik, i tretë në gusht dhe i fundit në shtator. Mirëpo nëse ka kërkesa specifike nga grupe tjera të interesit mund ta rrisim numrin e dëgjimeve buxhetore. Qëllimi i këtij takimi është marrja e inputeve nga qytetarët ta begatojmë KAB-in me projekte dhe ide dhe të mundohemi ti financojmë përmes buxhetit komunal apo edhe donacioneve. Aktualisht jemi në fazën fillestare ku marrim idet e juaja të cilat mund ti shprehni duke marrë fjalën apo duke i shënuar në listën e propozimeve. Secili prej jush do të marr informata qoftë në takimet e ardhshme apo në web faqen e komunës në lidhje me propozimet e tyre se në cilën fazë gjenden. Tani do tju shpalos burimet e financimit të cilat i kemi në dispozicion për vitin e ardhshëm.

Granti i përgjithshëm – 1,182,544.00 €
Granti specifik i Arsimit – 647,214.00 €
Granti specifik i shëndetësisë – 516,121.00 €
Gjithsej të hyrat nga grantet qeveritar – 2,345,879.00 €
Të hyrat vetanake – 193,595.00 €
TOTALI – 2,539.474.00 €

Nga vlera totale e buxhetit do të planifikohen shpenzimet operative si pagat, mallrat dhe shërbimet, Shpenzimet komunale ndërsa pjesa tjetër investime kapitale dhe subvencione.

Pas përfundimit të prezantimit, kryesuesi i grupit punues ua dha fjalën pjesëmarrësve për paraqitjen e propozimeve dhe kërkesave të tyre.

Propozimet e paraqitura

Z. Arton Krasniqi, në emër të Lagjes Krasniqi:

1. Ndërtimi i kanalit të ujitjes Miroc–Gjela, me gjatësi rreth 300 m.
2. Ndërtimi i kanalit të ujitjes Thana–Arrnica, me gjatësi rreth 500 m.

3. Ndërtimi i kanalit të ujitjes Thana–Ledina, me gjatësi rreth 1,000 m.
4. Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Shafrane, me gjatësi rreth 300 m.
5. Të bëhet kërkesë në KEDS për zëvendësimin e rrjetit të tensionit të lartë nga Lagjja Llojuni deri te Lapidari i Bashkim Lekut, për shkak të defekteve të shpeshta.
6. Rregullimi i kanalit ekzistues të ujitjes nga Mulliri i Qokut deri në qendër të lagjes, me gjatësi rreth 100 m.
7. Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza nga Poma Zem-Zem e poshtë.

Znj. Florije Shehu:

Ndërtimi i kanalit të ujitjes në rrugën "Gzim Pepshi", me trasenë si vijon:

- Nisja e kanalit ndërmjet parcelave nr. 1135-0 dhe 1136-0;
- Vazhdimi deri te parcela nr. 1092-0;
- Më pas vazhdon nga parcela nr. 1119-0 deri te parcela nr. 1173-3;
- Dalja e kanalit te Teqja.

Gjatësia e përgjithshme e kanalit parashihet të jetë rreth **740 metra**.

Z. Florant Pepshi:

1. Vazhdimi i kanalit të ujitjes në rrugën "Gështenja", me gjatësi rreth 150 m.
2. Ndërtimi i pendës te Qafa e Jasiqit.
3. Hapja e rrugëve fushore-malore në lokalitetin Trava, Lagjja Pepshi afërsisht 1050m
4. Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në rrugën "Gështenja".

Znj. Ferdone Tofaj:

1. Rindërtimi i pendës në Jaruha.
2. Rindërtimi i kanaleve të ujitjes në Bramatok.

Znj. Rajmonda Krasniqi:

1. Ndërtimi i një qendre për të moshuarit, me shërbime të kujdesit shëndetësor dhe ushqimit.
2. Sigurimi i shërbimeve të psikologut në shkolla.

Znj. Ilirjana Isufaj:

1. Ndërtimi i një qendre kulturore për të rinjtë.

Znj. Liberta Hoxha:

1. Vendosja e pengesave për ngadalësimin e shpejtësisë në rrugën "Shkëlzen Gacaferi".

Mbyllja e takimit

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 17 qytetarë prej tyre 11 të gjinisë femërore.

Meqenëse nuk pati propozime të tjera takimi u përmbyll duke i falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në procesin e planifikimit buxhetor.

Procesmbajtëse:

Klodiana Pepshi

 26/1